



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 283/5 Prot.

Tiranë, më 31.5.2024

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.35, datë 31.5.2024

“Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në institucionin në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me mbikëqyrjen e kryer në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 70, datë 19.07.2023, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (*aktualisht në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*).

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 798/1 prot., datë 19.07.2023, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike, me shkresat nr. 798/2, 798/3 dhe 797/4 prot., datë 19.7.2023, me lëndë: *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, i cili, i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 283 prot., datë 24.04.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Gjithashtu, ky material i është dërguar për njohje me shkresën nr. 283/2 prot., datë 24.04.2023, edhe Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse në administratën shtetërore.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 283/1 prot., datë 03.05.2024, *“Kthim përgjigje”*, ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Po kështu, nëpërmjet shkresës nr. 283/4 prot., datë 23.05.2024, *“Mbi projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil”*, pasi ka shqyrtuar projektraportin e përcjellë, ka dërguar një informacion sqarues në lidhje me procedurën e hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës në institucionin e mbikëqyrur.

Nga ana e institucionit, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, gjatë aplikimit të instituteve të ligjit si, hartimi i përshkrimeve të punës, vlerësimi i rezultateve në punë, masat disiplinore dhe procedura e ndjekur, etj. Gjatë procesit të mbikëqyrjes, janë vënë re edhe disa mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime dhe konkluzione në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- Rregullat e organizimit dhe funksionimit, të institucionit të mbikëqyrur, aktualisht parashikohen në Vendimin nr. 295, datë 20.03.2013, *“Për krijimin, organizimin dhe funksionim e ISHPSHSH-së”* të Këshillit të Ministrave dhe kjo situatë nuk është përditësuar, pasi nuk është pasqyruar ndryshimi i statusit të punësimit të punonjësve, si

nëpunës civilë, sipas përmbajtjes së ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

- Gjatë aplikimit të institutit të periudhës së provës, konstatohet se eprori direkt dhe njësia përgjegjëse e institucionit, nuk kanë treguar kujdes në lidhje me aktet për caktimin e nëpunësit me të vjetër nën kujdesin e të cilit do të kryejë detyrat secili punonjës që është emëruar rishtaz në shërbimin civil.
- Duke mbikëqyrur aplikimin në praktikë të institutit të përshkrimit të punës, konstatohet se formularët nuk janë nënshkruar nga në Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë përgjegjëse, që aktualisht është Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
- Në periudhën e vlerësimit të punës, rezulton se Zyrtarët raportues nuk kanë një kuptim të qartë lidhur me plotësimin e detyrueshëm të të gjitha rubrikave/nënndarjeve dhe hapësirave të formularit të vlerësimit, sidomos hapësira “*Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime*”. Po kështu, gjatë kësaj procedure, Eprori direkt i nëpunësit në proces vlerësimi, nuk ka respektuar fazat e ndërmjetme, të kërkuara gjatë procesit të vlerësimit, sepse ato nuk janë të materializuara në shënime, procesverbale, apo në përmbajtjen e formularit të vlerësimit të punës.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara gjatë mbikëqyrjes, të cilat janë të materializuara me hollësi në përmbajtjen e raportit përfundimtar, duhet të rregullohen nga subjekti që i ka lejuar, me qëllim që njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, të zbatojnë me korrektësi të gjitha kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Të kërkojë nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojnë paligjshmëritë duke vepruar si më poshtë:
 - a. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të përfundojë procesin e miratimit të përshkrimeve të punës për nëpunësit civil të institucionit të mbikëqyrur, duke i nënshkruar ato, në përputhje me kërkesat e ligjit.
 - b. Njësia e burimeve njerëzore, të finalizojë procesin, duke i depozituar këto akte pranë Departamentit të Administratës Publike.
 - c. Departamenti i Administratës Publike të mbikëqyrë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, deri në finalizimin e tij.
 - d. Zyrtarët vlerësues, në rolin e Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues, Zyrtarit Autorizues, në procesin pasardhës, të plotësojnë formularët e vlerësimit të punës duke pasqyruar procedurën e kërkuar nga ligji dhe zbatimin e fazave të këtij procesi; duke u kujdesur që të ketë objektivitet në vlerësim; duke materializuar komentet përkatëse dhe duke përdorur të gjithë spektrin ligjor të nivelit të vlerësimeve. Realizimi i kësaj detyre do të mbikëqyret në finalizimin e procesit pasardhës të vlerësimit të punës, pasi subjekti të njihet me vendimin e paralajmërimit dhe do të kryhet sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
 - e. Zyrtaret Kundërfirmues dhe Autorizues, të kujdesen për trajnimin e Zyrtarëve Raportues, në lidhje me procesin e vlerësimit të punës.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 (dy) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të

ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

5. Për këtë vendim të njoftohet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Ministrisë së Financave dhe *Ekonomisë (aktualisht Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit)*, Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha